



Raport i sondazhit për bujqësi

Prodhimi bimor

Përgatitur nga:
Fatlinda Muqiri

Përktheu dhe Lekturoi:
Etaglanse
Translation and Language Instruction

LISTA E SHKURTESAVE

OJQ	Organizatë joqeveritare
MPJQGJ	Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë Gjermane
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
PMB-të	Produktet për Mbrojtjen e Bimëve
FAO	Organizata Ndërkombëtare për Bujqësi dhe Ushqim
IPM	Menaxhimi i integruar i dëmtuesve
ADB	Agjentë të dëmshëm biologjikë

PËRMBLEDHJE

Ky raport është rezultat i sondazhit të zhvilluar me përfituesit e granteve nga projekti *"Mbështetje e stabilitetit shoqëror-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro-biznesit në Kosovë"* dhe *"Programi i trajnimit për vetëpunsim"*, projekte të cilat mbështen nga Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë Gjermane dhe që zbatohen nga përfaqësia në Kosovë e organizatës Help– Hilfe zur Selbsthilfe e.V. Organizata Help në Kosovë ofron ndihmë sociale dhe ekonomike për personat ndjeshëm ndaj varfërisë dhe dukurive negative shoqërore. Pikësynim i përgjithshëm i projekteve që zbatohen nga Help është të mbështetet zhvillimi i qëndrueshëm dhe stabiliteti në zonat e caktuara, me përqëndrim në fuqizimin ekonomik.

Ky është hulumtimi i parë që mbështetet në mendimet e marra përmes sondazhit nga prodhuesit, të cilët merren vetëm me prodhimtari bujqësore. Në këtë sondazh janë përfshirë 328 bujq nga regjione të ndryshme të Kosovës, nga gjithsej 22 komuna. Bujqit, të cilët kanë marrë pjesë në sondazh, janë ata të cilët merren kryesisht me kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore siç janë: pemishtet, vreshtat, drithërat, kopshtet e perimeve dhe fidanishtet. Në këtë sondazh nuk janë përfshirë blegtorët, bletarët dhe bujqit që merren me përpunim të produkteve të ndryshme bujqësore. Nga 328 bujq, sa kanë qenë përfitues të mjeteve dhe mekanizmave të ndryshëm bujqësorë, në sondazh janë përgjegjur 278 prej tyre, ose 85%. Në këtë raport është paraqitur një përmbledhje e rezultateve të studimit për shfrytëzimin e tokës bujqësore, kulturat bujqësore dhe inputet bujqësore për vitin 2020.

Përmbajtja

HYRJE	1
QËLLIMI I HULUMTIMIT	2
MATERIALI DHE METODAT E PUNËS	2
Regjionet ku është kryer hulumtimi	3
REZULATET	7
Shfrytëzimi i tokës së punueshme.....	8
Prodhimi Bimor	8
Drithërat	10
Perimet	10
Pemët dhe Vreshtat	11
MBROJTJA E BIMËVE	12
Barojat	16
Patogjenët	21
Dëmtuesit	23
PËRFUNDIME	29
GALERIA	32

HYRJE

Organizata Help është një organizatë gjermane joqeveritare me seli në Bon, që financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e qeverisë gjermane (MPJQGj) dhe e cila aktualisht u ofron ndihmë nevojtarëve në 23 vende të botës. Përfaqësia e organizatës Help në Kosovë - Help Kosovo, për herë të parë ka vepruar në Kosovë në vitin 1999, mirëpo në vazhdimsi ka qenë aktive që nga viti 2015. Projekti i parë që kjo organizatë e ka zbatuar në Kosovë ka qenë "Mbështetje e stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro-biznesit në Kosovë", përmes të cilit janë mbështetur sektorë të ndryshëm, ndër ta është edhe sektori i bujqësisë. Nga grantet që organizata Help i ka ndarë gjer më tash, 41% prej tyre i takojnë pikërisht këtij sektori. Sektori i bujqësisë vlerësohet si njëri nga sektorët më strategjik dhe me potencial më të madh në Kosovë, i cili mund të ndihmojë mjaft shumë në zhvillimin ekonomik të vendit. Reduktimi i varfërisë në zona rurale, mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore janë objektiva gjithnjë e më të rëndësishme për ekstensionin bujqësor, ku çështjet kryesore mjedisore përfshijnë:

- Ruajtjen e burimeve natyrore: (toka, uji, pyjet)
- Ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e mënyrës së menaxhimit të zonave të mbrojtura
- Ruajtjen e cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e liqeneve akumuluese
- Prodhimin e mjaftueshëm dhe cilësor
- Përmirësim të zinxhirit ushqimor në vend
- Sigurinë nga pesticidet dhe zvoglimin e mbetjeve
- Sigurinë ushqimore, etj.

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ka qenë që përmes sondazhit të zhvilluar me bujqit në zonat rurale të mblidhen informata për gjendjen aktuale dhe për mënyrat se si ata i kultivojnë kulturat bujqësore dhe të jepet një pasqyrë adekuate për përmirësimin e prodhimtarisë bujqësore në këto zona. Qëllim tjetër ka qenë që të sigurohen të dhëna se sa dhe si kanë ndikuar grantet në ekonominë dhe në veprimtaritë e tyre bujqësore.

Pikësynim i sondazhit ka qenë që të ofrojë të dhëna mbi kushtet e punës së bujqve, shfrytëzimin e tokës bujqësore, kulturat bujqësore dhe inputet bujqësore.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të mundësojnë ndërmarrjen e një varg nismave për përpilimin e standardeve ndërkombëtare dhe aplikimin e tyre, për një prodhimtari më të shëndoshë dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në vendin tonë.

MATERIALI DHE METODAT E PUNËS

Shënimet nga bujqit mbi veprimtarinë e tyre bujqësore janë marrë përmes metodës së intervistave ballë-për-ballë gjatë vizitave monitoruese në terren. Në pyetësin që është përdorur në këtë rast, janë përgjegjur gjithsej 114 bujq, ose 41% prej tyre. Ndërsa, 164 bujq, ose 59%, janë intervistuar përmes telefonit nga pamundësia e realizimit të vizitave për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19. Të dhënat e mbledhura gjatë intervistave të kryera përmes telefonit janë plotësuar direkt në data bazë në vendse në letër, pasi puna gjatë kësaj kohe ka vazhduar nga shtëpia për shkaqe të sigurisë.

Pyetësi ka përmbajtur pyetje për aktivitetet e bujqve në fermë, me theks të veçantë në llojin e kulturave bujqësore që ata kultivojnë, llojin e kultivimit që e praktikojnë (organik apo konvencional), llojin e masave mbrojtëse

që i aplikojnë për mbrojtje ndaj insekteve, mbrojtje nga sëmundjet dhe barojat, etj.

Sondazhi është realizuar gjatë periudhës 03 shkurt – 17 prill 2020.

Hulumtimi është zhvilluar në tri faza:

- Faza përgatitore
- Faza e hulumtimit në terren (plotësimi i pyetësorëve gjatë intervistave me bujqit)
- Faza e përpunimit të të dhënave

Faza përgatitore- Përgatitja e pyetësorit dhe klasifikimi i regjioneve për vizita tek bujqit.

Faza e hulumtimit- Bazohet në sondazhin e zhvilluar në terren dhe përfshinë plotësimin e pyetësorëve gjatë intervistave ballë-për-ballë si dhe një pjesë të sondazhit që është zhvilluar përmes telefonit. Në pyetësorë janë përgjigjur gjithsej 278 bujq.

Faza e përpunimit të të dhënave- është faza përfundimtare që përfshinë përpunimin e të dhënave që kanë rezultuar nga sondazhi dhe paraqitjen e tyre në formë të tabelave dhe figurave.

Regjionet ku është kryer hulumtimi

Kosova ka formë shumë të përshtatshme - në skajet e saj shtrihen malet e larta, të mesme dhe të ulëta, ndërsa në pjesët e brendshme janë fushat, luginat dhe malet e ulëta. Pozita gjeografike e saj kushtëzon që ajo të këtë klimë me tipare të karakterit kontinental me ndikim mesdhetar. Sipërfaqja e tokës së Kosovës është e ndarë në dy rrafshë: Rrafshin e Dukagjinit dhe Rrafshin e Kosovës. Të dy këto rrafshë kanë tokë bujqësore, e cila përmbush kriteret për bujqësi.

Sondazhi është zhvilluar në pothuajse në gjitha regjionet, në gjithsej 22 komuna të Republikës së Kosovës.

1. **Në komunën e Prishtinës** janë intervistuar gjithsej 68 bujq në fshatrat: *Dabishec, Keqekollë, Mramor, Marec, Prapashticë, Bardhosh, Hajvali, Grashticë, Rimanishtë, Shashkovc, Barilevë, Besi, Ballaban, Hajkobillë.*
2. **Në komunën e Prizrenit** janë intervistuar gjithsej 10 bujq në fshatrat: *Randobravë, Novak, Serbicë e Poshtme, Kabash i Hasit, Lubishtë e Hasit, Krushë e Vogël, Reçan.*
3. **Në komunën e Pejës** janë intervistuar gjithsej 20 bujq në fshatrat: *Nobergjan, Zahaq, Qyshk, Radavc, Gllaviqicë, Llozhan, Lutogllavë, Novosellë, Blagajë, Jabllanicë e Madhe, Vitomericë, Graboc, Katun i Ri.*
4. **Në Komuna e Gjakovës** janë intervistuar gjithsej 17 bujq në fshatrat: *Cemjan, Jabllanicë, Gregoc, Rogovë, Planqor, Jahoc, Raç, Zhdrell, Rashkoc, Kodrali, Bec, Batushë, Nivokaz, Gerkovc, Dobrigjë.*
5. **Në komunën e Mitovicës** janë intervistuar gjithsej 17 bujq në fshatrat: *Broboniq, Zhabar, Suhudoll i Epërm, Ribar, Vinarc i Epërm, Bajgorë, Kçiç i Vogël, Pirq, Mazhicë, Bare, Zasellë, Lushtë.*
6. **Në komunën e Ferizajit** janë intervistuar gjithsej 8 bujq në fshatrat: *Fshat i Ri, Bablak, Varosh, Greme, Kosinë, Gacka, Epopeja e Jezercit.*
7. **Në komunën e Gjilanit** janë intervistuar gjithsej 11 bujq në fshatrat: *Ponesh, Nasale, Llashticë, Sllakoc i Epërm, Shillovë, Zhegër, Livoq i Ulët, Livoq i Epërm, Malishevë e Ulët, Kmetoc, Gumnishtë, Dobërqqan, Cernicë.*
8. **Në komunën e Vitisë** është intervistuar 1 bujk nga fshati: *Gjylekarë.*
9. **Në Komunën e Vushtrrisë** janë intervistuar gjithsej 16 bujq në fshatrat: *Studime e Poshtme, Studime e Epërme, Bukosh, Akrashticë, Maxhunaj,*

Sllakoc, Vernicë, Dumnicë e Poshtme, Pestovë, Mihaliq, Brusnikë, Gllatvotin.

10.Në komunën e Suharekës janë intervistuar gjithsej 15 bujq në fshatrat: Grejkoc, Peqan, Samadrexhë, Bllace, Bukosh, Gjinoc, Vershec.

11.Në komunën e Istogut janë intervistuar gjithsej 13 bujq në fshatrat: Dubravë, Dobrushë, Carallukë, Lubovë, Zabllaq, Cerrq, Lluga, Kerrninë, Lubozhdë, Shushicë.

12.Në komunën e Deçanit janë intervistuar gjithsej 11 bujq në fshatrat: Drenoq, Prekolluk, Gramaqel, Carabreg i Epërm, Bablloqe, Drenoc.

13.Në komunën e Lipjanit janë intervistuar gjithsej 22 bujq në fshatrat: Vershec, Ribar i Vogël, Gadime e Ulët, Gadime e Epërme, Babush, Janjevë, Akllap, Banullë, Ruboc, Sllovi, Brus, Hallaq i Vogël, Rusinoc, Krojmirë, Dobrajë e Madhe, Konjuh, Gumnasellë, Teqe.

14.Në komunën e Kaçanikut është intervistuar vetëm 1 bujk.

15.Në komunën e Leposaviqit është intervistuar vetëm 1 bujk.

16.Në komunën e Novobërdës janë intervistuar gjithsej 16 bujq në fshatrat: Prekoc, Gkusce, Zebnicë, Koretish, Bostane, Vllasali, Izvor, Kolonia e Vjetër, Tërniqevc, Parallovë, Bushinqë, Straza, Prekoc, Parallovë, Koznicë, Kusce e Epërme.

17.Në komunën e Graçanicës janë intervistuar gjithsej 8 bujq në fshatrat: Livade, Kishnicë, Susica, Dobrotinë, Batushe, Gusterica.

18.Në komunën e Shtërpses janë intervistuar gjithsej 15 bujq në fshatrat: Gotovushë, Vrbeshtica, Biti e Poshtme, Biti e Epërme, Sushicë, Brod.


19.Në komunën e Fushë Kosovës janë intervistuar gjithsej 3 bujq në fshatrat: Bardh i Madh, Sllatinë e Vogël, Harilaq, Lismirë.

20.Në komunën e Drenasit është intervistuar vetëm 1 bujk në fshatin *Llapushnik*.

21.Në komunën e Obiliqit janë intervistuar gjithsej 3 bujq në fshatrat: Breznicë, Palaj, Kozaricë.

22.Në komunën e Hanit të Elezit është intervistuar vetëm 1 bujk në fshatin *Dremjak*.

Figura 1. Sipërfaqet e tokës punuese të llogaritura në/ha



REZULATET

Sipas sondazhit, për sa i përket asaj se sa kanë ndikuar mjetet e punës te bujqit, ata kanë deklaruar se i janë mirënjohës organizatës Help që, përmes granteve, u ka dhënë mundësinë t'i përmirësojnë kushtet e tyre të punës. Bujqit gjithashtu kanë shtuar se me ndihmën e mjeteve të fituara ata tash janë shumë më efikas në punë dhe mund të punojnë sipërfaqe më të mëdha të tokës bujqësore. Shumë prej tyre kanë deklaruar se Help është “zë i shpresës për ferma të vogla”, meqë më parë ata nuk kishin pasur mundësi të përfitonin grante të tilla nga organizata ose institucione të ngjashme në vend.

Tabela 1. Deklarime të bujqve gjatë vizitave

L.K: Nga fshati Bardhosh, ka deklaruar se me përfitimin e grantit nga organizata Help, në formë të pajisjeve për ngrohje në serrë, janë përmisuar shumë kushtet e punës dhe se tash e gjithë familja punon në serra, ku merren me kultivimin e fidaneve të specit dhe domates.

D.V: Nga fshati Marec, i cili është përfitues nga sektori i bletarisë, ka thënë se nga ky grant ka pasur përfitime të shumëfishta, pasi me përmisimin e kushteve të punës, bletët kanë ndikuar shumë në polenizimin e pemëve të cilat ai i kultivon. Si pasojë e kësaj, pemët tash japin rendiment shumë më të lartë.

A.F: Nga fshati Prapashticë, ka thënë se me përfitimin e mjeteve të punës, parmendës dhe frezës, puna e tij është lehtësuar shumë, pasi tash ai më nuk ka nevojë të paguaj bujq të tjerë për lëvrimin e tokës dhe ka më pak shpenzime. Po ashtu ai tash kultivon kultura të ndryshme bujqësore në një sipërfaqe më të madhe.

Shfrytëzimi i tokës së punueshme

Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore nënkupton sipërfaqen e përgjithshme të tokës së punueshme-arat, livadhet, kulturat shumëvjeçare dhe kopshtet e përdorura nga bujqit. Bazuar në madhësinë e sipërfaqes së tokës së punueshme madhësia e fermave që janë përfshirë në sondonazh ka qenë mesatarisht 2.1/ha.

Tabela 1.2. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore nga bujqit e intervistuar

Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqja/ha
Tokë e punueshme - ara	946.65
Plantacione të perimeve	321.9
Plantacione të pemëve	145.09
Plantacione të vreshtave	7.9
Fidanishte	1
Livadhe	200
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës	1622.54

Prodhimi Bimor

Tabela 1.2. Llojet e kulturave që kultivohen në regjionin e Kosovës


Kulturat e mbjellura	Sipërfaqja / ha
Grurë (<i>Triticum vulgare</i>)	460.13
Misër (<i>Zea mays L.</i>)	433.02
Patate (<i>Solanum tuberosum L.</i>)	110.22
Molla (<i>Malus domestica</i>)	61.24
Qepë (<i>Allium cepa L.</i>)	55.3

Domate (<i>Solanum lycopersicum</i>)	42.38
Specë (<i>Capsicum annuum</i> L.)	41.2
Kumbulla (<i>Prunus domestica</i>)	28.96
Tërshërë (<i>Avena sativa</i>)	28.5
Mjedra (<i>Rubus idaeus</i>)	25.92
Dardha (<i>Pyrus</i>)	24.5
Jonxh (<i>Medicago sativa</i>)	23
Lakër (<i>Brassica oleracea</i>)	18.45
Tranguj (<i>Cucumis sativus</i>)	11.65
Fasule (<i>Phaseolus vulgaris</i> L.)	10.7
Vreshta (<i>Vitis</i>)	7.9
Kunguj (<i>Cucurbita pepo</i> L.)	6.5
Marule (<i>Lactuca sativa</i> L.)	6.05
Shalqi (<i>Citrullus lanatus</i>)	4.75
Bimë mjekësore (<i>Medicinal herbs</i>)	4.1
Asparagus (<i>Asparagus officinales</i>)	3.3
Pjepër (<i>Cucumis melo</i>)	3.1
Arra (<i>Juglans regia</i>)	2.8
Karrota (<i>Daucus carota</i> L.)	2.6
Elb (<i>Hordeum sativum</i>)	2
Dredhëza (<i>Fragaria vesca</i>)	1.67
Hudhër (<i>Allium sativum</i> L.)	1.6
Totali	1421.54

Drithërat

Në Kosovë sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 418 581.76/ha. Ndër drithërat, më të rëndësishme janë gruri dhe misri, të cilat janë edhe kulturat kryesore që mbillen në vendin tonë. Sipërfaqja e përgjithshme e mbjellur me grurë dhe misër nga bujqit e përfshirë në sondazh ishte 933.63/ha. Kjo sipërfaqe përfshinte plantacionet e mbjellura me drithëra me madhësi mesatare 2.5/ha. Sipas të dhënave nga Departamenti i Mbrojtjes dhe Prodhimtarisë Bimore (MBPZHR) rendimenti për drithëra është 3.46 t/ha. (Fig. 1)

Figura 1. Drithërat




Perimet

Sipas MBPZHR, perimet e mbjellura në fushë të hapur dhe në serra në Kosovë mbulojnë gjithsej sipërfaqe prej 9289,06/ha. Sipërfaqja e mbjellur me perime nga bujqit që janë përfshirë në sondazh ishte 317.05/ha. Perimet më të rëndësishme janë patatja - me sipërfaqe 110.22 dhe rendiment 19.08 t/ha, qepa - me sipërfaqe 53.3 dhe rendiment 13.77 t/ha, domatja - me sipërfaqe 42.38 dhe rendiment 9.90t/ha dhe speci - me sipërfaqe 41.2 dhe rendiment 16.43t/ha.

Sipërfaqet e mbjellura me perime ishin plantacione të vogla me madhësi mesatare 2.1/ha. (Fig. 2)


Figura 2. Perimet



Pemët dhe Vreshtat

Sipërfaqja e plantacioneve të pemëve në Kosovë është 7687,40 ha. Sipërfaqet e mbjellura me pemishte dhe vresha janë sipërfaqe të vogla, ku mesatarja e madhësisë së plantacioneve është 1.5/ha. Sipas (MBPZHR), ndër pemët në Kosovë, dominon molla - e kultivuar në një sipërfaqe prej 61.24/ha me rendiment 10.21 t/ha, kumbulla - që mbulon sipërfaqe prej 28.96 me rendiment 5.38 t/ha; ndërsa, vreshtat mbulojnë sipërfaqe prej 7.9/ha me rendimentit 8.4 t/ha. (Fig. 6)

Figura 6. Pemët dhe Vreshtat



MBROJTJA E BIMËVE

Mbrojtja nga dëmtuesit dhe parazitët është një hallkë shumë e rëndësishme në zinxhirin e kultivimit të bimëve pa të cilën nuk mund të merren rendimente të larta, të qëndrueshme dhe me cilesi të lartë. Prandaj mbrojtja e bimëve duhet të fillojë me masat agroteknike. Sipas FAO-s humbjet në shkallë botërore, që vijnë nga sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat, qysh nga momenti i mbirjes e deri në vjeljen e prodhimit, llogaritet të jenë 30-40%. Në Kosovë dominon sistemi tradicional i prodhimtarisë bujqësore. Për kalim nga bujqësia tradicionale në atë moderne është shumë e rëndësishme të bëhen hulumtime të bazuara në rezultate shkencore.

Sipas sondazhit të realizuar, vetëm 5% e bujqve i bëjnë analizat e tokës, kurse pjesa dërmuese (95%) nuk i bëjnë analizat për arsye të kostos, pasi nuk kanë mundësi financiare. Për plehërim të tokës, 44% përdorin pleh organik, kurse 56% përdorin pleh inorganik, ku më së shumti e përdorin plehun e kombinuar me

Azot, Fosfor dhe Kalium (NPK-15:15:15). Po ashtu bujqit kanë deklaruar se përdorin edhe plehëra foliare.



Për plehërim organik, bujqit përdorin pleh shtalle, varësisht nga kafshët shtëpiake të cilat i posedojnë (Fig.7); ndërsa, 39% e tyre kanë deklaruar se bëjnë kompost, që është një mënyrë e mirë e menaxhimit të mbeturinave bimore, pasi kështu reduktohen mbeturinat duke u transformuar në materie organike, si humusi, i cili më pas luan rol të rëndësishëm në përmisimin e strukturës së tokës dhe në rritjen e aktivitetit mikrobiologjik. Sa i përket prodhimit organik, bujqit kanë deklaruar se nuk kanë çertifikime të produkteve organike.

Figura 7. Lloji i plehrave që përdoret






Figura 8. Bujqit që bëjnë kompost



Përdorimi i farërave është një ndër veprimtaritë më të rëndësishme të bujqësisë, pasi rendimentet e larta janë rezultat i përdorimit të farërave të zgjedhura dhe me aftësi të lartë prodhuese. Bujqit e përfshirë në sondazh kanë pohuar se 66% e farës, të cilën e përdorin për mbjellje, është farë hibride, ndërsa pjesa tjetër (34%) janë popullacione ose farë, të cilën bujqit e ruajnë vit pas viti.


Popullacionet kryesisht përdoren nga bujqit që merren me kultivimin e drithërave, të cilat përdoren për bagëti. (Fig. 9)

Figura 9. Farat për mbjellje



Një masë tjetër agroteknike që ndërmarrin bujqit është qarkullimi bimor, i cili ka një rëndësi shumë të madhe në përmisimin e strukturës së tokës, ku përmes parandalimit të sëmundjeve dhe të dëmtuesve të ndryshëm dhe kontrollimit të barojave rritet prodhimi. Bujqit, të cilët praktikojnë qarkullimin bimor, përbënin 49% të atyre që morën pjesë në sondazh. (Fig. 9)


Figura 10. Bujqit që e praktikojnë qarkullimin bimor



Barojat


Rezultatet e sondazhit për kultivimin e kulturave bujqësore në regjionet, ku është zhvilluar hulumtimi gjatë vitit 2020, tregojnë se pjesa më e madhe, 57% e bujqve, përdorin pesticide. Shumica kanë deklaruar se kanë njohuri për pesticide, për përdorimin e tyre dhe se e respektojnë karencën; ndërsa, një pjesë kanë thënë se bashkëpunojnë me disa bujq të tjerë për trajtimin e sipërfaqeve bujqësore, të cilat ata i kultivojnë. Prej bujqve që kanë marrë pjesë në sondazh, 43% përdorin kryesisht masa mbrojtëse të ndryshme (masa agroteknike, mekanike, fizike etj.) për kontrollin e agentëve të dëmshëm biologjikë (ADB-ve). (Fig. 11)

Figura 11. Bujqit që përdorin pesticide



Rezultatet e sondazhit kanë treguar se **HERBICIDET** janë grupi i pesticideve që përdoret më shumë për arsye se bujqit kanë treguar për probleme të shumta me kontrollin dhe menaxhimin e barojave, veçanërisht në kulturën e drithërave. (Fig. 12)

Figura 12 . Bujqit që kanë problem me baroja



Kontrolli i barojave ka rëndësi të madhe pasi ato konkurojnë me bimët e kultivuara për hapësirë, lëndë ushqyese, dritë dhe ujë. Disa baroja gjithashtu dëmtojnë cilësinë e produkteve të fermës dhe të produkteve blegtorale, shkaktojnë alergji tek njerëzit, janë bartëse të shumë dëmtuesve, sëmundjeve, etj.

Ndër barojat më të përhapura tek drithërat është Tërshëra e egër (*Avena fatua*), e cila paraqet rrezik më të madh për prodhimin e drithërave, pasi vështirë dallohet nga të lashtat. Mirëpo, në drithëra dhe perime janë të pranishme edhe barojat gjethe gjëra dhe gjethe ngushta, siç janë:

BAROJAT NË DRITHËRA
Tërshëra e egër - <i>Avena fatua</i>
Gjembi i arave - <i>Cirsium arvense</i>
Ngjitësi - <i>Galium aparine</i>
Konsolidë e bigëzuar - <i>Consolida regalis</i>
Konsolidë orientale - <i>Consolida orientalis</i>
Dredhja e arave - <i>Convolvulus arvensis</i>
Biforë rrezake - <i>Bifora radia</i>
Muhari - <i>Echinochloa crus-galli</i>
Egjëra - <i>Lolium perenne</i>
Flokëz njëvjeçar - <i>Poa annua</i>
BAROJAT NË PERIME
Stelare e ndëmjetme - <i>Stelaria media</i>
Nena e përveshur - <i>Amaranthus retroflexus</i>
Minuer i bardhë - <i>Chenopodium album</i>
Tatulla - <i>Datura stramonium</i>
Bordullak - <i>Portulaca oleracea</i>
Solanum nigrum - Solane e zezë

Disa nga bujqit kanë treguar se nga herbicidet selektive në kulturën e grurit përdorin:

- **Sekator OD** (Amidosulfuron+ jodosulfuron-metil-natrium+protektant mefenpir-dietil)
- **Dikamin-720 ESC** (2,4-D dimetil amonium)
- **Husar Evolution** (Fenoksaprop-P etil + jodosulfuron-metil-natrium + mefenpir-dietil)

Disa të tjerë kanë thënë se nga herbicidet selektive në kulturën e misrit përdorin:

- **Dikamin-720 esc** (2,4-D -dimetil amonium)
- **Nicogan** (Nicosulfuron)
- **Merlin flexx OD** (Izoksaflutol+ciprosulfamid)
- **Maister OD**(Foramsulfuron+jodosulfuron-metil natrium+izoksadifen)

Disa bujq kanë thënë se nga herbicidet selektive në kulturën e perimeve përdorin:

- **Sencor EG 70** (Metribuzin) Patate dhe Domate
- **Mistral** (Metribuzin) Patate
- **Galigan** (Oskiflurofen) Qepë




Shumë nga bujqit kanë deklaruar se nga herbicidet jo selektive me veprim sistematik dhe kontakti në Pemishte zakonisht përdorin:

- **Taifun** (Glifosat)
- **Basta 15** (Glufosinat amonium)

Ndërsa, sa i përket djegies së hamullorëve, 98% e bujqve të intervistuar kanë thënë se nuk e djegin tokën. Megjithatë, shume herë e pësojnë edhe arat e tyre për shkak të disa bujqve të tjerë, të cilët nuk janë të vetëdijshëm për dëmet që i shkakton zjarri. Pasi me djegien e tokës humbet edhe materia organike, po ashtu shkatërrohen edhe të gjithë organizmat e tjerë të gjallë (bakteret, kërpudhat, algat, protozoa, skraja e shiut, etj.), të cilët janë të dobishëm dhe ndikojnë në proceset e formimit të lëndës organike në tokë. (Fig. 13)


Figura 13. Bujqit që e djegin tokën



Patogjenët

Procesi, nga prodhimi i kulturave deri në vjelje, është shumë i rëndësishëm për pemët, perimet dhe drithërat. Në mënyrë që ato të mos i humbasin vlerat e tyre ushqyese teksa kalojnë nëpër faza të ndryshme, duhet të mbahen në kushte të shëndetshme, higjienike dhe t'u servohen konsumatorëve në mjedise të pastra. Prandaj, duhet të tregohet kujdes i vazhdueshëm pasi bimët që janë të ekspozuara ndaj shumë sëmundjeve, të cilat shkaktohen nga faktorë të ndryshëm (insektet, parazitët, viruset, kërpudhat, marimangat, bakteret) dhe nga shumë mikroorganizma të tjerë. Sa u përket problemeve me patogjenë, 35% e bujqve të intervistuar kanë treguar se kanë probleme me patogjenë. (Fig. 14)

Figura 14. Bujqit që kanë problem me patogjenë



Probleme me patogjenë më së shumti ka pasur në kulturën e mjedres, ku bujqit kanë treguar se kanë pasur problem me Kalbëzimin i rrënjëve (*Phytophthora fragaria*); ndërsa, dyshohet se ka pasur probleme edhe me Tharjen e fidanëve të mjedrës (*Didymella appianata*) dhe kancerin e rrënjëve dhe llastarëve

(*Agrobacterium tumefaciens*). Shumica e bujqve kanë thënë se fidanet e mjedrës i kanë marrë donacion dhe se nuk kanë pasur çertifikatë fitosanitare për shëndetin e tyre. Shumë prej bujqve tashmë nuk merren më me kultivimin e mjedrës për shkak të problemeve të mëdha që janë paraqitur në plantacionet e tyre dhe ata dëshirojnë të kultivojnë kultura të tjera. Për kulturën e specit, disa bujq kanë raportuar probleme me Antraknozën (*Colletotrichum spp*), ndërsa, për drithërat kanë thënë se me to nuk kanë probleme të theksuara.

Sa i përket grupit të **FUNGICIDEVE**, bujqit kanë thënë se pemishtet e tyre kryesisht i trajtojnë me:

- **Vajra minerale**
- **Preparate me bazë bakri**

Ndërsa, për kulturat perimore, përdorin fungicidet:


- **Aliette Flash** (Fosetyl aluminium)
- **Previcure** (Propamokarb fosetylat)



Dëmtuesit

Si dëmtues kryesorë në kultura bujqësore llogariten insektet, që përbëjnë grupin më të madh të dëmtuesve, pastaj janë marimangat, nematodat dhe ADB-të e ndryshëm, të cilët me praninë e tyre shkaktojnë dëme mjaft serioze në bujqësi, pylltari dhe bezdisjse tek njerëzit. Insektet në bimë shkaktojnë dëme në mënyrë direkte dhe indirekte. Në mënyrë direkte, kur ushqehen me lëngje të bimëve; ndërsa, në mënyrë indirekte, kur bëhen vektorë të sëmundjeve në bimë, sidomos të atyre virusale. Përhapja e tyre varet nga disa faktorë si: kushtet e mjedisit, kushtet klimatike, teknologjia e kultivimit, lloji i dëmtuesit dhe nga niveli i masave që merren kundër tyre. Sa u përket dëmtuesve, 58% e bujqve të intervistuar kanë raportuar për probleme me dëmtues dhe kanë thënë se përdorin insekticide të ndryshme për kontrollin e tyre, ndërsa pjesa tjetër nuk kanë probleme. (Fig. 15)

Figura 15 . Bujqit që kanë probleme me dëmtues



Ndër dëmtuesit më problematikë tek perimet, në veçanti tek kultura e Patates sipas këtij sondazhi ka dalë të jetë Bubërreci i patatës (*Leptinotarsa decemlineata*); ndërsa, tek Domatja, kohëve të fundit në vendin tonë ka mjaft probleme me Tenjën e domates (*Tuta absoluta*), i cili është një insekt mjaft i dëmshëm dhe prek familjen Solanaceae, në veçanti Domatën. Edhe morrat e bimëve (*Aphidae spp*) janë mjaft të pranishëm në shumicën e kulturave bujqësore. Dëmtues tjetër tek pemishtet është edhe (*Cydia pomonella*, *C. fenebrana*).


INSEKTICIDET që përdoren për kontrollin e dëmtuesve janë:

- **Mavrik** (Tau-fluvalinate)
- **Kohinor** (Imidacloprid)
- **Savanur** (Hlorpirifos + cipermetrin)
- **Actara 25 ËG** (Thiamethoxam)
- **Mospilan** (Acetamiprid)




Bazuar në rezultatet e pyëtësorit, 66% e bujqve nuk konsultohen me agromonë ose nuk punojnë sipas direktivave të ekspertit lokal, pra, vetëm 34% prej tyre i zbatojnë këto direktiva. (Fig. 16)

Figura 16. Bujqit që punojnë sipas direktivave




Deponimi i pesticideve është me rëndësi të veçantë, sepse ato duhet të ruhen në hapësira të veçanta, të kenë ambalazhe origjinale, të jenë të ndara nga ushqimi për njerëz dhe kafshë, të mbahen larg gjësendeve të tjera për përdorim të gjerë dhe larg fëmijëve. Në bazë të rezultateve të sondazhit, për sa i përket ruajtjes së pesticideve në vende dhe kushte të përshtatshme, vetëm 3% prej bujqve kanë thënë se posedojnë dollap për pesticide, pra, pjesa më e madhe e tyre (97%) nuk posedojnë dollap. Në përgjithësi bujqit i aplikojnë masat mbrojtëse në bazë të praktikave të tyre kryesisht tradicionale. (Fig. 17)

Figura 17. Bujqit që posedojnë dollap për pesticide




Për sa i përket mbajtjes së shënimeve në fermë, 93% e bujqve që kanë marrë pjesë në sondazh kanë thënë se nuk mbajnë shënime, kurse një numër i vogël i tyre (7%) mbajnë shënime për përdorimin e pesticideve, të cilat i aplikojnë në kulturat bujqësore dhe gjatë aktiviteteve të tyre në fermë. (Fig. 18)

Figura 4. Bujqit që mbajnë shënime




Gjithashtu, shumica e bujqve kanë shprehur interesim për të ndjekur trajnime për bujqësi, në veçanti për mbrojtje të bimëve. (Fig. 19)

Figura 19. Interesimi i bujqve për trajnime




Për kushtet e tregut, bujqit kanë thënë se nuk kanë marrëveshje paraprake për shitjen e prodhimeve, si dhe kanë shprehur interesim për mundësinë e shitjes direkte. (Fig. 20)

Figura 20. Bujqit që kanë marrëveshje për shitje të produkteve




Bujqit, të cilët janë të interesuar ta rrisin aktivitetin e tyre afarist përbëjnë 83% të të intervistuarve, meqë shumica prej tyre të ardhurat në familje i kanë vetëm nga ky sektor. Gjithashtu, ata dëshirojnë të ndikojnë në rritjen dhe ekstensionin bujqësor në zonat rurale dhe në uljen e importit në vend (shumica e produkteve në vend janë të importuara), duke e furnizuar tregun me produkte vendore cilësore dhe të sigurta për konsum, që i plotësojnë kriteret. Shumica e bujqve që nuk kanë treguar interesim për rritjen e aktivitetit të tyre afarist (17%) ishin nga komuna e Shtërpçës. Arsyeja e mungesës së interesimit për disa nga këta bujq qëndron në faktin se një pjesë e parcelave bujqësore është dëmtuar nga ndërtimi i Hidrocentralit në lumin Lepenc; ndërsa, një pjesë tjetër kanë thënë se u mungojnë pajisjet elementare, si p.sh., traktori, dhe nuk kanë mundësi ta zhvillojnë aktivitetin e tyre. (Fig. 21)

Figura 21 . Bujqit që mendojnë ta zgjerojnë aktivitetin e tyre afarist



Sa u përket vizitave nga inspektorët komunalë ose nga përfaqësuesit e institucioneve të tjera që operojnë në vend, bujqit kryesisht kanë deklaruar se nuk kanë vizita të tilla, ose në disa raste kanë thënë se ato janë shumë të rralla. (Fig. 22)

Figura 22. Vizitat e institucioneve te bujqit



PËRFUNDIME

Rezultatet e sondazhit në bujqësi – Prodhimtari bimorë në regjionet e hulumtuara gjatë vitit 2020, kanë treguar se:

- Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore që shfrytëzohet nga bujqit e intervistuar është 1622.54/ha. Sipërfaqja më e madhe e tokës së punueshme është e mbjellur me drithëra 946.65/ha. Ndër perimet kryesore dominon Patatja e mbjellur në sipërfaqe prej 110. 22 /ha, kurse nga Pemët dominon molla e kultivuar në një sipërfaqe prej 61.24/ha.
- Fermat janë kryesisht të vogla, me madhësi mesatare 2.1/ha.

- Për prodhimin organik, 43% e bujqve kanë thënë se aplikojnë vetëm plehëra organike dhe nuk përdorin pesticide, ndërsa pjesa dërmuese (57%) e praktikojnë prodhimtarinë konvencionale.
- Pothuajse të gjithë bujqit mund të ofrojnë prodhime, të cilat kërkohen në tregun organik, por kanë nevojë për trajnime dhe edukim specifik për këtë lloj të prodhimtarisë, si dhe sipas mundësive, duhet të bëhet edhe certifikimi i produkteve organike që ata i prodhojnë.
- Si masë agroteknike, 49% e bujqve aplikojnë qarkullimin bimor, kurse si material për mbjellje, 66% përdorin farë hibride, kurse 34% përdorin popullacione.
- Ndër grupet e pesticideve, herbicidet janë ato që përdoren më shumë. Prej bujqve të intervistuar, 62% kanë raportuar probleme me baroja. Ndër barojat më të përhapura në drithëra është *Avena fatua*, kurse në perime *Stellaria media*.
- Nga bujqit që janë përfshirë në sondazh, 35% kanë thënë se kanë probleme me patogjenë, ku probleme të tilla më së shumti paraqiten në kulturën e mjedres. Sëmundja më e përhapur është *Phytophthora fragaria*, por dyshohet edhe për *D.applanata* dhe *A.tumefaciens*. Te perimet bujqit kanë treguar për probleme me patogjenin *Colletotrichum spp.* Megjithatë, shumica e bujqve të intervistuar (65%) nuk kanë raportuar probleme me patogjenë.
- Dëmtuesit paraqesin problem për mbi gjysmën e bujqve të intervistuar (58%). Dëmtuesit më të përhapur te perimet janë *Leptinotarsa decemlineata* dhe *Tuta absoluta*.

- Shumë bujq kanë deklaruar se nuk i përdorin të gjitha masat mbrojtëse (syzet, rrobat mbrojtëse, dorëzat etj.) dhe se nuk kanë shumë njohuri për parametrat e caktuar, të cilat duhet të përdoren për të qenë sa më pak të ekspozuar ndaj faktorëve të dëmshëm për njerëzit, për të shkaktuar sa më pak ndotje të mjedisit dhe të kulturave bujqësore, meqë shumica zbatojnë metoda tradicionale. Kjo dhe është njëra ndër arsyet pse rendimenti është shumë i ulët në kulturat bujqësore, gjë që e thekson nevojën që kanë bujqit për mbështetje profesionale në këtë fushë. Ndër shumë faktorë të tjerë, shkak i rendimentit të ulët është edhe mungesa e mekanizmit përkatës që shumica e bujqve nuk e posedojnë.
- Në të ardhmen bujqve duhet t'u ofrohet më shumë mbështetje përmes subvencioneve dhe në forma të tjera që ua mundësojnë atyre zbatimin e standardeve evropiane, përfshirë standardet GLOBAL GAP dhe IPM.

GALERIA

Bujq nga komuna e Prishtinës





Bujq nga komuna e Lipjanit



Bujq nga komuna e Novobërdës



Bujq nga komuna e Shtërpcës



Bujk nga komuna e Gjakovës

